

mbante në vetëvete rrezikun e komprometimit të kolektivizimit, sepse ende nuk qenë krijuar kushtet për riorganizimin socialist të gjithë bujqësisë. Partia e ndreqi me kohë këtë vendim të shpejtuar. Në maj u mbledh përsëri Plenumi i Komitetit Qendror. Ai theksoi se për kushtet konkrete detyrë kryesore nuk ishte zgjerimi i kolektivizimit në fshat, por forcimi i kooperativave bujqësore të ngritura dhe shfrytëzimi i të gjitha mundësive të ekonomisë së vogël fshatare për të rritur prodhimin.

Partia, duke vlerësuar drejt të gjitha kushtet, mundësitë dhe mjetet, arriti në përfundimin se për ta çuar bujqësinë përpara rruga më e mirë për atë kohë ishte forcimi dhe përsosja e mëtejshme e lidhjeve ekonomike midis qytetit dhe fshatit, rregullimi i shpërpjesëtimeve midis industrisë dhe bujqësisë.

Gjatë vitit 1951 u shtua ndihma për fshatin. U morën masa për ndreqjen e gabimeve që ishin bërë në kadastër dhe në klasifikimin e tokave. Detyrimi i drithërave u ul mesatarisht 25 për qind dhe u përjashtuan nga tatimi ekonomikë bujqësore individuale që kishin të ardhura vjetore të pakta.

Duke qenë se përpjesëtimi i çmimeve të mallrave industriale e bujqësore ishte i tillë që nuk e nxiste fshatarësinë për të shtuar prodhimet dhe për ta tërhequr tërësisht në tregun reciprok, KQ i Partisë mori vendim të ulëshin çmimet e mallrave industriale. Zbritja e re e çmimeve të këtyre mallrave në vitin 1951 e zvogëloi deri në një farë mase shpërpjesëtimin në çmime.

Në të njëjtën kohë u punua për forcimin e kooperativave të shitblerjes, për t'i bërë ato organizata të fuqishme masash që ndihmonin për lidhjen ekonomikisht dhe politikisht të fshatit me qytetin.

Masat ekonomike për ta nxjerrë bujqësinë nga prapambetja u shoqëruan me një punë të gjerë politike dhe organizative të Partisë.

4. KONGRESI II I PPSH. DETYRAT PËR SHNDËRRIMIN E SHQIPËRISË NË NJË VEND BUJQËSOR-INDUSTRIAL

Kongresi II i PPSH zhvilloi punimet nga 31 marsi deri më 7 prill 1952. Në kongres morën pjesë 592 delegatë me votë deliberative dhe 142 me votë konsultative, që përfaqësonin 44 418 anëtarë dhe kandidatë partie. Efektiviteti i Partisë në këtë

kongres ishte pak më i vogël se në Kongresin I, kryesisht për arsye se gjatë vërtetimit të dokumenteve u përjashtuan 8 për qind të numrit të anëtarëve të partisë.

Direktivat e planit të parë pesëvjeçar Kongresi e gjykoj plotësisht të mundshëm zhvillimin ekonomik dhe kulturor të vendit në bazë të një plani me afate më të gjata. Ai pranoi direktivat e planit të parë pesëvjeçar për vitet 1951-1955.

Para se të pranoheshin nga Kongresi, këto direktiva u diskutuan për më tepër se dy muaj në organizatat e partisë dhe në mbledhje të hapëta të punonjësve të qytetit dhe të fshatit.

Hartimi i planit u mbështet para së gjithash në forcat e në burimet e brendshme, në përvojën e fituar dhe në aftësitë e kuadrove të vendit. Ai u mbështet gjithashtu në ndihmën e Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe të vendeve të tjera socialiste. Ndihma që Bashkimi Sovjetik i jepte Republikës Popullore të Shqipërisë në këtë kohë synonte kryesisht në zhvillimin e forcave prodhuese në vend, që ekonomia popullore të mund të ecte me këmbët e veta. Partia e çmonte këtë ndihmë si faktor të jashtëm të rëndësishëm për ndërtimin e socializmit.

Detyrat kryesore të planit të parë pesëvjeçar ishin: **shpejtimi i ritmeve për ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit dhe për zhvillimin e forcave prodhuese me qëllim që në fund të pesëvjeçarit Shqipëria të shndërrohej nga një vend i prapambetur bujqësor në një vend bujqësor-industrial, forcimi i aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse dhe rritja e nivelit material dhe kulturor të masave punonjëse.**

Si hallkë kryesore për plotësimin e këtyre detyrave Partia përcaktoi krijimin e industrisë së re socialiste. Në fakt industrializimi i vendit kishte filluar që me planin dyvjeçar, por një program i madh dhe i gjerë për ndërtimin e bazave të industrisë socialiste u hartua në Kongresin II.

Partia vlerësoi drejt parimin, sipas të cilit prodhimi i mjetëve të prodhimit luan rolin vendimtar në zhvillimin e industrisë dhe të gjithë ekonomisë popullore. Në përputhje me këtë parim një rëndësi e madhe iu kushtua zhvillimit dhe krijimit të degëve të industrisë së rëndë. Por nuk u synua në zhvillimin e gjithë degëve të kësaj industrie, për arsye se vendi nuk kishte mundësitë ekonomike dhe teknike për një gjë të tillë. Makineria e nevojshme do të sigurohej nga vendet socialiste nëpër-

mjet shkëmbimeve dhe kredive. Në Shqipëri do të zhvilloheshin ato degë të industrisë së rëndë, për të cilat kishte burime natyrore, që paraqitnin më tepër leverdi ekonomike dhe kishin rëndësi të veçantë strategjike. Në kushtet konkrete të vendit industria e rëndë do të përbëhej kryesisht nga minierat, industria mekanike, industria elektrike dhe industria e materialeve të ndërtimit. Pikërisht këto degë parashikohej të zhvilloheshin me ritme më të shpejta. Vendin e parë e zinte industria minerare.

Meqenëse vendi kishte nevoja të mëdha e të ngutshme për mallra të përdorimit të gjerë dhe me qëllim që të pakësohej importi i tyre, në plan zuri një vend të rëndësishëm zhvillimi i industrisë së lehtë dhe ushqimore, që do të mbështetej kryesisht në shfrytëzimin e lëndës së parë të vendit.

Për të siguruar rritjen e shpejtë të prodhimit industrial që përcaktonte plani, parashikoheshin investime 3 herë më të mëdha se në pesë vjetët 1946-1950.

Detyrat e Kongresit II për industrinë mund të zgjidheshin po qe se kapërceheshin dy pengesa kryesore: e para, ritmet e ulëta të zhvillimit të bujqësisë; e dyta, mungesa e kuadrove teknike dhe niveli arsimor-teknik i ulët i punëtorëve. Kapërcimit të këtyre pengesave iu kushtua një kujdes i posaçëm.

Për të shpejtuar rritjen e prodhimit bujqësor, Kongresi zhvilloi e konkretizoi më tej direktivat e Partisë për forcimin e kooperativave bujqësore, për forcimin e për zgjerimin e ndërmarrjeve bujqësore e blegtorale, për zgjerimin e SMT-ve e mekanizimin e bujqësisë, për shtimin e ndihmës shtetërore ndaj fshatarësisë punonjëse me kredit bujqësor e me mjete të tjera. Fshati do të furnizohej me më shumë artikuj industrialë. Për këtë qëllim do të bëhej një rregullim i mëtejshëm i përpjesëtimit midis çmimeve të artikujve industrialë e bujqësorë.

Detyrë kryesore në bujqësi u vu shtimi i prodhimit të drithërave të bukës. Do të zgjerohej edhe prodhimi i bimëve industriale, si një kërkesë e ligjshme e zhvillimit të industrisë.

Për plotësimin e detyrave në bujqësi qe parashikuar të investoheshin rreth dy herë më tepër se në pesë vjetët 1946-1950.

Në lidhje të ngushtë me zhvillimin e ekonomisë do të zhvillohej me një ritëm më të shpejtë revolucioni kulturor. Gjatë pesëvjeçarit të parë rrjeti i arsimit do të zgjerohej në një shkallë mjaft të madhe, numri i përgjithshëm i nxënësve do të

shtohet më tepër se tri herë e gjysmë në krahasim me vitin 1938, numri i agronomëve — më shumë se pesë herë, kurse numri i inxhinierëve — 18 herë. Gjithashtu do të përgatiteshin përmbi 8 500 teknikë të mesmë dhe rreth 54 000 punëtorë të kualifikuar.

Kongresi tërhoqi vëmendjen e Partisë në prapambetjen e krahinave të Veriut, si Kukësi, Tropoja, Mirdita, Puka etj. dhe porositi që t'i kushtohet një kujdes i veçantë ngritjes kulturore të tyre.

Plani pesëvjeçar parashikonte zhdukjen e analfabetizmit.

Rritja e prodhimit industrial e bujqësor do të ndihmonte për rritjen e mirëqenies së masave punonjëse dhe do të përgatiste kushtet për heqjen e sistemit të triskëtimit.

Për ngritjen e mirëqenies materiale dhe zhvillimin kulturor të popullit shteti do të shpenzonte afër tri herë e gjysmë më shumë se gjatë 5 vjetëve 1946-1950.

Plani i parë pesëvjeçar shënonte një fazë të re në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të vendit me ritme të shpejta. Plotësimi i tij do të krijonte kushtet e domosdoshme për të hyrë në fazën përfundimtare të ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit.

Të përmirësohet metoda e udhëheqjes politike nga ana e Partisë

Kongresi trajtoi si një problem me rëndësi shumë të madhe për plotësimin e planit të parë pesëvjeçar dhe të detyrave të tjera të mëdha: përsosjen e metodës së udhëheqjes politike të Partisë. Ai kritikoi shfaqjet oportuniste ndaj armiqve të klasës, burokratizmin, monopolizimin nga komitetet e partisë të punës që duhej të kryenin organet shtetërore, metodën e një pune deklarative, të një pune të paktë politike të vërtetë, aktivizimin e pamjaftueshëm të të gjithë komunistëve dhe të organizatave të masave etj. Shoku Enver Hoxha e godiste prirjen për të zgjidhur problemet me mbledhje dhe vendime pa fund me këto fjalë: «Bëhen mbledhje mbi mbledhje që zgjatën me orë dhe me ditë të tëra dhe shumë pak gjë mbetet mbi shoshë»¹.

¹ Enver Hoxha. Raport në Kongresin II të PPSH. Vepra, vëll. 9, f. 185.

«Merren vendime, bile shumë, por nuk zbatohen të gjitha. Atëherë merren gati po aq vendime për të zbatuar vendimet që janë marrë më parë. Merren gjithashtu vendime të reja për çështje që janë vendosur, por janë harruar. Kësaj i thonë të tallesh me punën dhe me vendimet, të hiqesh sikur punon duke pjellë vendime, por në realitet s'bën gjë, qëndron në vend dhe pengon punën»¹.

Duke u bazuar në përvojën e fituar, Kongresi përcaktoi si kushtin më kryesor për të siguruar plotësimin e planit të parë pesëvjeçar: «Të përmirësohet dhe të forcohet drejtimi i Partisë në ekonomi. Të forcohet dhe të përmirësohet puna për lidhjen e ngushtë të problemeve ekonomike me punën politike. Të ushtrohet kontrolli i vazhdueshëm, sistematik e rigoroz mbi zbatimin e vendimeve dhe të detyrave të Partisë e të shtetit. Të luftohet për një punë të organizuar mirë dhe për zhdukjen e burokratizmit në punë»².

Organet qendrore e lokale si edhe organizatat e partisë u ngarkuan të rishikonin dhe të përmirësonin metodën e punës në përgjithësi. Parimet leniniste të udhëheqjes kolegjiale, të dhënies llogari të organeve drejtuese përpara masës së komunistëve që i kishin zgjedhur, të kritikës dhe autokritikës, të rolit të masave punonjëse, si ndërtuese të socializmit, dhe të organizatave të tyre, si leva të forta të Partisë, të përgatitjes sistematike marksiste-leniniste të anëtarëve të partisë të mos mbereshin vetëm si shprehje teorike që i pranonin dhe i propagandonin të gjithë, por të viheshin në jetë me këmbëngulje dhe plotësisht.

Njëkohësisht Kongresi i porositi në mënyrë të veçantë komunistët të qëndronin gjithnjë syhapur, të mos harronin për asnjë çast kanosjen që i vinte Partisë nga presioni që ushtronin imperialistët e titistët nga jashtë, kulakët dhe armiqtë e tjerë të klasës nga brenda. Nga përvoja e luftës që kishte Partia kundër shmangieve dhe kundër armiqve të saj të brendshëm pas Çlirimit, sidomos në periudhën midis dy kongreseve, u arrit në përfundimin se rreziku kryesor ishte oportunizmi i djabatë, si pjellë e gjunjëzimit përpara presionit imperialisto-revizio-

1 Enver Hoxha. Raport në Kongresin II të PPSH. Vepra, vëll. 9, f. 184.

2 Rezolucioni i Kongresit II të PPSH. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. II, f. 271-272.

nist. «Të konsiderohet deviacioni i djathtë, oportunizmi si rreziku më i madh i Partisë sonë... pa harruar aspak rrezikun e deviacionit të majtë... Presioni i borgjezisë mbi Partinë tonë duhet të konsiderohet si një rrezik shumë serioz dhe duhet të luftohet vazhdimisht me forcën më të madhe»¹.

Në njërën dorë kazmën, në tjetrën pushkën

Kongresi e paralajmëroi Partinë dhe popullin se në përpjekjet e tyre për plotësimin e planit të parë pesëvjeçar do të hasnin shumë vështirësi, për kapërcimin e të cilave kërkoheshin gatishmëria e gjithanshme morale e materiale, politike dhe ushtarake.

Vështirësitë qenë të ndryshme. Vështirësitë e rritjes ishin të lidhura me prapambetjen që trashëgonte vendi nga e kaluara, me mungesën e përvojës, me përgatitjen e pamjaftueshme tekniko-kulturore të kuadrove dhe të punëtorëve në përgjithësi. Këto do të kapërceheshin duke u vënë përballë organizimin, disiplinën, bindjen e masave në drejtësinë e vijës së Partisë dhe mobilizimin e këtyre të fundit.

Vështirësi do të krijonin armiqtë e brendshëm, të cilët me përkrahjen e armiqve të jashtëm do të përpiqeshin të minonin zhvillimin e vendit në rrugën e socializmit. Këto vështirësi duhej të kapërceheshin me luftë klasore të ashpër, të drejtë, të gjithanshme, në fshat, në qytet, kundër kulakëve, kundër borgjezisë, sabotatorëve, kusarëve, kundër ideologjisë borgjeze, kundër burokratizmit, oportunizmit, sektarizmit. Të gjithë duhej ta kishin të qartë, theksonte Kongresi, se «lufta e klasave nuk është shuar dhe as që do të shuhet derisa ekzistojnë klasat në vendin tonë, deri në triumfin e plotë të socializmit»².

Në të njëjtën kohë Partia dhe populli duhej të ishin plotësisht të përgatitur për të përballuar vështirësitë që do të krijonin imperialistët dhe revizionistët jugosllavë me veprimtarinë e tyre armiqësore të drejtpërdrejtë, të shumanshme e të pareshtur kundër RPSH. Armiqtë e jashtëm po thurnin plane të reja për të asgjësuar rendin e demokracisë popullore në Shqipëri. Qeveria jugosllave së bashku me qeveritë greke dhe turke, me nxitjen dhe përkrahjen e imperialistëve amerikanë,

¹ Rezolucion i Kongresit II të PPSH. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. II, f. 277.

² Enver Hoxha. Raport në Kongresin II të PPSH. Vepra, vëll. 9, f. 265.

po përgatisnin krijimin e paktit agresiv të Ballkanit që drejtohej kundër Shqipërisë.

I nisur nga kjo gjendje, Kongresi e theksoi parullën e Partisë, e cila ishte bërë motoja kryesore në veprimtarinë e masave popullore pas Çlirimit të vendit: «Të ndërtojmë socializmin, duke mbajtur në njërën dorë kazmën dhe në dorën tjetër pushkën»¹. Ai vuri detyrë të mprihej vigjilenca dhe t'i kushtohej një rëndësi shumë e madhe forcimit të vazhdueshëm të unitetit të popullit rreth Partisë. U kërkua të mos kursehej asgjë për rritjen e aftësisë mbrojtëse të atdheut, për përsosjen e mëtejshme të Ushtrisë Popullore, të Forcave të Kufirit dhe të Sigurimit të Shtetit.

Duke dënuar agresionin e imperialistëve të SHBA në Kore dhe gjithë politikën luftënxitëse dhe agresive të tyre, Kongresi porositi të punohej pa pushim për forcimin e urrejtjes së popullit kundër imperializmit, sidomos kundër imperializmit amerikan, për demaskimin e tij të plotë. Ai e cilësoi luftën kundër imperializmit si kushtin kryesor për ruajtjen dhe forcimin e paqes.

Gjithashtu u shpreh solidariteti me klasën punëtore ndërkombëtare dhe me të gjithë popujt që luftonin për çlirimin e tyre nga zgjedha e imperializmit. U vu detyrë të forcohej më tej miqësia e bashkëpunimi me vendet socialiste dhe u ritheksua domosdoshmëria për demaskimin e klikës së Titos si agjenturë e imperializmit.

Kongresi zgjodhi Komitetin Qendror të Partisë me 27 anëtarë e 12 kandidatë. Enver Hoxha u rizgjodh Sekretar i Përgjithshëm i Partisë.

5. PËR NGUSHTIMIN E SHPËRDPJESËTIMIT MIDIS INDUSTRIËS E BUJQËSISË DHE PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS

Zbatimi i planit të parë pesëvjeçar hasi në pengesa që nuk ishin parashikuar si duhet. Plan i zhvillimit të ekonomisë për vitet 1951 e 1952 nuk u plotësua. Shkalla e parashikuar për rritjen e mirëqenies së punonjësve nuk u arrit. Prodhimi buj-

1 Dokumente kryesore të PPSH, vëll. II, f. 289.

qësor eci me ritme më të ngadalshme se ato që përcaktoi Kongresi. Në një kohë kur sipërfaqet e mbjella me bimë bujqësore qenë zgjeruar sipas planit, rendimentet e tyre, sidomos të drithërave, kishin mbetur prapa. Kishte një rënie të ndjeshme në blegtori. Doli që shpërpjesëtimi midis industrisë dhe bujqësisë, në vend që të ngushtohej, ashtu si parashikohej në plan, qe thelluar.

Shkaqet e shpërpjesëtimit midis industrisë e bujqësisë

Kjo gjendje ngjalli një shqetësim të madh në Komitetin Qendror. Ai e shqyrtoi atë në mënyrë të posaçme dhe

zbuloi shkaqet që e kishin krijuar.

Prapambetja që trashëgonte bujqësia nga e kaluara, shka-lla e ulët arsimore e kulturore e masave fshatare dhe prona e vogël private në fshat pengonin përdorimin e gjerë të teknikës dhe shfrytëzimin e të gjitha mundësive të krijuara për rritjen e prodhimit bujqësor. Orientimi i drejtë i Kongresit II për një zhvillim më të shpejtë të bujqësisë dhe për ngushtimin e shpërpjesëtimit midis industrisë dhe bujqësisë nuk u mbajt parasysh sa duhet dhe nuk gjeti pasqyrimin e gjithanshëm në shifrat e planit. Investimet për bujqësinë ishin më të vogla edhe se investimet në transport. Kjo nuk i përgjigjej detyrës që vuri Kongresi për të rritur prodhimin bujqësor në fund të pesëvjeçarit 171 për qind, kryesisht me anë të rritjes së rendimenteve.

Ndërkaq ndërtimet e veprave të reja industriale u zgjeruan jashtë forcave e mundësive. Ritmi i caktuar për mbarimin e disa veprave të mëdha doli se ishte i papërbalueshëm. Ndërtimi i këtyre veprave kërkonte një shtim shumë të madh të fuqisë punëtore me një mesatare vjetore prej 26 000 vetash. Nxjerrja e kësaj fuqie punëtore shkaktoi largimin e një numri të madh fshatarësh nga bujqësia.

Përveç të metave në planifikim, për zhvillimin e bujqësisë ndikonin për keq detyrimet e fshatarit ndaj shtetit që ishin të larta, tatimet bujqësore që ishin ende të rënda. Detyrimet u bënë të papërbalueshme për fshatarët, sidomos për shkak të thatësisës së viteve 1950-1952.

Thatësira i solli dëme të mëdha bujqësisë, ajo shkaktoi edhe pakësimin e bagëtive. Numri i ekonomive bujqësore që nuk zotëronin qe pune zbriti në 1/3 e gjithë ekonomive të Republikës, në një kohë kur sipërfaqet e punuara ishin shtuar,

llojet dhe vëllimi i punimeve bujqësore ishin zgjeruar, kurse mekanika bujqësore ishte e pamjaftueshme.

Rendimentet e parashikuara në prodhimin e drithërave nuk u arritën edhe për arsye se një pjesë e tokave më të mira u zunë me bimë industriale. Zgjerimi i sipërfaqeve të mbjella me këto bimë u bë në mënyrë të pastudiuar, pa përfillur shpesh vullnetin e fshatarëve dhe krahët e punës që kërkonin shërbimet e këtyre bimëve.

Shpërpjesëtimi në raportin midis çmimeve të mallrave industriale e bujqësore, me gjithë masat që mori Partia, nuk qe zhdukur plotësisht. Fshatari me të ardhurat që siguronte përballonte kështu me vështirësi blerjen e veglave bujqësore. Vështirësi për pajisjen e fshatarëve me vegla bujqësore kishte edhe për arsye se industria dhe artizanati nuk kishin prodhuar sasinë e caktuar të këtyre veglave.

Mosarritja e përparimeve të parashikuara në bujqësi pengonte drejtpërdrejt zbatimin e detyrave për prodhimin e artikujve të përdorimit të gjerë. Kjo shkaktonte vështirësi në furnizimin e popullit dhe nuk lejonte përmirësimin e jetesës së punonjësve të qytetit dhe të fshatit.

Rritja e mirëqenies pengohej gjithashtu edhe nga disa rrethana të tjera. Të shtyra nga prirja për fitime, kooperativat e konsumit kryenin grumbullimin dhe shpërndarjen e artikujve bujqësorë, si edhe shitjen e veglave bujqësore kryesisht me anë të tregut të lirë, duke mos siguruar kështu mallrat e nevojshme në tregun e garantuar dhe reciprok. Shtimi i madh i numrit të punëtorëve nga radhët e fshatarësisë që zbrisnin në qytete kërkonte investime të reja për strehimin e furnizimin e tyre dhe të familjeve me mallra të racionuara. Në pakësimin e mallrave në treg kishte ndikuar për keq edhe orvatja për të zhdukur tregtinë e vogël private me masa administrative dhe para kohe, pa mbajtur parasysh orientimin e dhënë nga Komiteti Qendror për këtë çështje.

Masat në dobi të bujqësisë dhe për rritjen e mirëqenies së punonjësve

Partia nuk mund të lejonte që të vihej në rrezik plotësimi i planit të parë pesëvjeçar dhe të dobësohej

aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë. Komiteti Qendror në mars 1953 vendosi të merreshin një varg masash që synonin zhdukjen e pengesave për përparimin e bujqësisë dhe për

rritjen e produkteve bujqësore. Si rrjedhim, u shtua deri-diku ndihma për fshatin, u siguroa që përfundimi i veprave të bonifikimit të kryhej brenda afatit, u përmirësua puna e SMT-ve, u shpejtua përgatitja e kuadrit për bujqësinë.

Por doli që këto masa prapë ishin të pamjaftueshme dhe nuk mund ta zgjidhnin plotësisht problemin, sepse nuk siguronin burime të reja për zgjerimin e ndihmës së shtetit ndaj fshatit, si një hallkë kryesore për ta çuar bujqësinë përpara.

Partia nxori mësimet se zgjidhja e problemeve të fshatit duhej parë më mirë dhe nga të gjithë si një çështje e madhe politike dhe se duheshin marrë masa më të studiuara e më rrënjësore.

Në këtë mënyrë, me iniciativën e Komitetit Qendror dhe nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë të tij, gjatë vitit 1953 Këshilli i Ministrave mori masa të reja shumë të rëndësishme në dobi të bujqësisë, në interes të rritjes së mirëqenies së punonjësve të fshatit e të qytetit.

U rishikua përpjesëtimi i investimeve të planit të parë pesëvjeçar për degët kryesore të ekonomisë. U hoqën nga plani disa vepra industriale të parakohshme. U ulën ritmet e ndërtimit të disa veprave të tjera. Pjesa më e madhe e investimeve që u liruan nga industria kaluan në bujqësi, kurse një pjesë tjetër kaloi për shtimin e mallrave të përdorimit të gjerë dhe për ndërtimin e banesave.

U falën të gjitha detyrimet e prapambetura të fshatarëve deri në vitin 1952 në drithëra e në produkte të tjera bujqësore e blegtorale si edhe tatimet financiare të prapambetura për tërë anëtarët e kooperativave bujqësore dhe ekonomitë bujqësore individuale që nuk kishin pendë pune, ndërsa për ato që kishin u ulën në masën 75 për qind. Detyrimet për të gjitha kategoritë e tokave u zvogëluan. Pak më vonë u bë një zbritje e përgjithshme e tatimeve për ekonomitë fshatare në masën 25 për qind. Gjithashtu u ulën çmimet e veglave bujqësore të prodhuara në vend dhe u ngritën çmimet e blerjes nga shteti të ullirit, të pambukut, të duhanit dhe të panxharsheqerit.

Njëkohësisht u vendos të rritej në një masë të rëndësishme krediti bujqësor dhe të pajisej bujqësia me një numër më të madh traktorësh.

U shkurtua aparati i administratës shtetërore dhe i organeve të masave 30 për qind, një numër kuadros të admi-

nistratës shkuan në prodhim, mjaft prej tyre u dërguan në fshat.

U shfuqizuan urdhëresat që shpinin në zhdukjen e tregtisë së vogël private dhe u morën masa për një farë gjallërimi të saj. Në të njëjtën kohë u forcua tregtia shtetërore e kooperativiste. Në vazhdim të përpjekjeve për të përmirësuar jetesën e punonjësve, Partia i kushtoi një rëndësi të madhe zhvillimit të industrisë së lehtë, pa hequr dorë nga zhvillimi i industrisë së rëndë, me qëllim që të shtoheshin mallrat e përdorimit të gjerë. Për të plotësuar sa më mirë nevojat e fshatit me artikuj industrialë u nxit artizanati privat dhe u punua për ngritjen e artizanatit në fshat.

Të gjitha këto masa dëshmonin për forcën e Partisë, për zotësinë e saj për të rishikuar me sy kritik dhe për të ndrequr me kohë vendimet e veta në përshtatje me kushtet konkrete. Partia e kishte të qartë se udhëheqja e ndërtimit të socializmit nuk mund të kuptohej pa i rishikuar herë pas here detyrat, pa i shfuqizuar vendimet që koha i kishte nxjerrë jashtë përdorimit, pa plotësuar boshllëqet që dilnin gjatë rrugës. V.I. Lenini në kohën e vet shpjegonte se socializmi nuk mund të ndërtohet «pa një numër shumë të madh përsëritjesh, pa u kthyer dësa herë prapa, pa kontrolluar punën, pa bërë korrigjime të veçanta, pa metoda të reja. . . »¹.

Masat që morën KQ i Partisë dhe Qeveria gjatë vitit 1953, me gjithë rëndësinë e tyre të madhe, mbeteshin masa nga lart.

Për të arritur përparimet e dëshiruara në zhvillimin e ekonomisë, në mënyrë të veçantë të bujqësisë, ishte e nevojshme të bëhej një mobilizim i gjithanshëm i burimeve dhe i forcave njerëzore, të ngrihej në një shkallë më të lartë vrulli revolucionar dhe iniciativa krijuese e masave. Kjo do të sigurohej po qe se do të vihej në jetë porosia e Kongresit II për të përmirësuar rrënjësisht metodën e udhëheqjes politike nga ana e Partisë në ekonomi.

Për të përmirësuar metodën e udhëheqjes, Partia e përqendroi punën e vet, para së gjithash, në zgjidhjen e dy kontradiktave të rëndësishme.

Kontradikta e parë ishte midis përgatitjes së pamjaftueshme tekniko-profesionale e arsimore të kadrove drejtues dhe

¹ V.I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 572.

kërkesave gjithnjë më të mëdha për drejtimin e ekonomisë popullore në zhvillim të vrullshëm e të gjithanshëm. Ritmi i përgatitjes së kuadrove, ngritja e shkallës së tyre arsimore e teknike, rritja e aftësive të tyre organizuese duhej t'u përgjigjeshin kërkesave për një drejtim të përsosur të çështjeve ekonomike e shtetërore.

Kontradikta tjetër ishte midis teknologjisë së lartë të prodhimit dhe shkallës së ulët tekniko-profesionale të punëtorëve dhe të personelit inxhiniero-teknik. Në Shqipëri po ngrihej një industri e re, me procese të ndërlikuara prodhimi, e bazuar në një teknikë moderne, ndërsa përgatitja e punëtorëve, e teknikëve dhe e inxhinierëve nuk ishte në gjendje të përballonte kërkesat e saj. Kjo gjë shkaktonte që të mos shfrytëzoheshin gjithë aftësitë e makinerisë, që rendimenti i punës të ishte i ulët dhe që kostoja e prodhimit të qëndronte e lartë.

Për zgjidhjen e këtyre kontradiktave Komiteti Qendror i Partisë e rishqyrtoi përgatitjen dhe kualifikimin e kuadrove e të punëtorëve, kritikoi dobësitë në këtë fushë dhe mori masa për t'i vënë këto punë mbi baza më të shëndosha.

Këto masa nuk vonuan të jepnin përfundime të kënaqshme të dukshme. Në vitin 1954 plani i prodhimit industrial u tejkalua në një shkallë më të madhe se çdo vit tjetër. Po ashtu u rritën sipërfaqet e mbjella si edhe prodhimi i drithërave. Rënia e blegtorisë u ndalua dhe filloi një shtim i ndjeshëm i numrit të bagëtive. Punonjësve iu shpërnda një sipërfaqe banimi 27 për qind më e madhe se në vitin 1953. Qarkullimi i përgjithshëm i mallrave u shtua mbi 13 për qind brenda një viti. U zgjeruan shkëmbimet midis qytetit dhe fshatit.

Të gjitha këto shpunë në forcimin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë dhe përgatitën truallin për plotësimin e gjithë planit pesëvjeçar.

6. FORCIMI I PUNËS IDEOLOGJIKE DHE SHKATËRRIMI I ORVATJEVE PËR REVIZIONIMIN E VIJËS MARKSISTE-LENINISTE TË PARTISË

Pas Kongresit I të Partisë, sidomos në vitet e planit të parë pesëvjeçar, revolucioni kulturor e ideologjik u shtri dhe u thellua në të gjitha drejtimet. U ngrit shkalla e arsimit dhe e kulturës së punonjësve. Arsimi e kultura qenë bërë me të vër-

tetë të popullit. Mbarë vendi ishte mbuluar nga një rrjet i dendur shkollash, teatros, kinemash, shtëpish dhe vatrash kulturore. Qenë ngritur institutet e para të larta mësimore. Në çdo shtatë veta të popullsisë së vendit njëri ndiqte shkollën. Patriotizmi tradicional i popullit shqiptar ishte pajisur me një përmbajtje të re socialiste. Ndryshime të thella ishin bërë në ndërgjegjen e punonjësve. Kishte lindur një qëndrim i ri, socialist, ndaj punës dhe pronës shoqërore; ata qenë çliruar nga shumë paragjykime prapanike, fetare, borgjeze e mikroborgjeze.

Megjithatë, përgatitja ideologjike e kulturore e komunistëve dhe e gjithë punonjësve mbetej mjaft e ulët. Kjo dukej në punën dhe në jetën e tyre. Shfaqjet e huaja për moralin komunist, kujdesi i paktë për ngritjen ideologjike, shkalla e ulët e punës ideopolitike, tërheqja përpara vështirësive në pajisjen me arsim e kulturë e pengonin ndërtimin socialist të vendit.

Ngritja e edukimit ideopolitik e kulturor në një shkallë më të lartë

Kthesa që kishte filluar në fushën e rritjes së prodhimit dhe të drejtimit të ekonomisë, mbrojtja dhe

zhvillimi pa ndërprerje i fitoreve të revolucionit socialist kërkonin të ngrihej në një shkallë më të lartë pjesëmarrja e gjallë e masave në jetën politike, ekonomike e kulturore të vendit, rrjedhimisht, të kalitej ndërgjegjja e tyre socialiste. Shqipëria kishte hyrë në rrugën e zhvillimit socialist në kushtet e një prapambetjeje të madhe ekonomike e kulturore, me një klasë punëtore të vogël në numër, me një nivel të ulët arsimor e kulturor e me një botëkuptim mikroborgjez të theksuar të punonjësve. Ajo e ndërtonte socializmin në kushtet e rrethimit kapitalist, kur imperializmi dhe agjentët e tij ushtronin një presion të gjithanshëm e të fortë mbi popullin dhe Partinë, zhvillonin një fushatë të gjerë shpifjesh e kërcënimesh me qëllim që të përmbysnin pushtetin popullor.

Duke e vlerësuar edukimin ideopolitik marksist-leninist të komunistëve dhe të punonjësve si një detyrë themelore, Komiteti Qendror i Partisë e shqyrtoi në mënyrë të posaçme këtë çështje dhe mori masa për ta organizuar më mirë dhe për ta vënë në pozita më luftarake.

U kritikua prirja e zëvendësimit të metodës së bindjes me metoda administrative në punën me masat. U dënua mendimi i gabuar, sipas të cilit kur partia vihet në krye të pushtetit komandon e jep urdhra. U goditën veçanërisht rastet kur disa komunistë në fshat, në vend që të bënin një punë bindëse me fshatarët për të dorëzuar detyrimet e drithit, gjenin rrugën më të shkurtër duke kryer veprime arbitrare, si mbylljen e mullinjve, ndalimin e fshatarëve për të shpënë prodhimet në shtëpi pa shlyer detyrimet etj.

Komitetet e partisë organizuan një punë më të gjerë dhe më konkrete për të shpjeguar vijën politike të Partisë. Puna sqaruese politike u lidh më ngushtë me problemet ekonomike, me detyrat për plotësimin e planeve të ndërmarrjes, të fshatit ose të institucionit. Vëmendje të veçantë iu kushtua edukimit të punonjësve me qëndrimin socialist ndaj punës dhe pronës shoqërore. Si një hallkë kryesore në vargun e problemeve të edukimit ideologjik Partia kapi më mirë problemin e luftës së klasave. Ajo e bëri edhe më të qartë domosdoshmërinë e kësaj lufte dhe nuk lejoi të zinte rrënjë në mendjen e komunistëve dhe të punonjësve ideja antimarksiste «mbi shuarjen e luftës së klasave në periudhën e ndërtimit socialist» që e përhapnin revizionistët jugosllavë dhe që kishin filluar ta për-krahnin ideologë të ndryshëm në disa parti komuniste e punëto-re, duke përfshirë dhe PKBS. Komiteti Qendror kërkonte të rrënjosej thellë në mendjen e komunistëve e të punonjësve konkluzioni i Kongresit II të PPSH se lufta e klasave do të vazhdojë pa pushim në gjithë periudhën e ndërtimit socialist. Klasat shfrytëzuese, pasi kanë humbur pushtetin, nuk heqin kurrë dorë nga orvajtjet për të rivendosur sundimin e vet, kurse borgjezia ndërkombëtare ka si pikësynim kryesor të mos lejojë fitoren e socializmit në shkallë botërore, të asgjësojë revolucionet socialiste atje ku kanë triumfuar ose atje ku ato shpërthejnë. Lidhur me këtë, Partia e forcoi edhe më shumë propagandën e agjitacionin për demaskimin e qëllimeve të imperialistëve e të shërbëtorëve të tyre, të formave të reja që ata përdornin për të arritur këto qëllime. Ajo bëri që punonjësit t'i kuptonin më mirë format e ndryshme të luftës së klasës, duke u tërhequr vëmendjen se një shprehje e luftës klasore ishin edhe vjedhjet, dëmtimet e shpërdorimet e pronës socialiste.

U morën masa për të përmirësuar punën e shtypit e të radios, si armë të fuqishme edukimi e mobilizimi në duart e Partisë. U riorganizua sistemi i edukimit në parti. U zgjerua botimi i letërsisë marksiste-leniniste. Krahas me veprat e J. Stalinit që kishin filluar të botoheshin që nga viti 1952, u vendos dhe filloi botimi i veprave të plota të V. I. Leninit. Në mënyrë të veçantë u përqendrua kujdesi për ngritjen e nivelit ideologjik, arsimor e profesional të punonjësve të aparateve të partisë dhe të kuadrove të organeve shtetërore dhe ekonomike. Në punën e edukimit ideopolitik u vunë në lëvizje më mirë të gjithë kuadrot dhe gjithë komunistët, duke thyer kështu mendimin krejt të gabuar e të dëmshëm se gjoja kjo punë ishte detyrë vetëm e organeve të agjitacionit e të propagandës.

Për ta çuar përpara revolucionin kulturor, Partia përqendroi vëmendjen në zhvillimin e tij më tepër në thellësi, pa lënë pas dore edhe zgjerimin e mëtejshëm. Iu kushtua kujdes i posaçëm forcimit të brendisë shkencore dhe ideopolitike të shkollës.

Me krijimin e inteligjencies së re dhe me ngritjen e vatrave shkencore në vend, Partia shtroi tani detyrën për ta lidhur më fort shkencën me prodhimin në mënyrë që kërkimet shkencore të zgjidhnin problemet kryesore të zhvillimit socialist të vendit. Masa të veçanta u morën për të nxitur më shumë studimet në fushën e historisë së Shqipërisë e të gjuhësisë.

Pikërisht në këtë kohë u krijuan një varg institucionesh të reja shkencore, kulturore dhe artistike, si Instituti i Historisë së Partisë, Instituti i Historisë e i Gjuhësisë, Teatri i Operas e i Baletit etj.

Vigjilenca e Partisë për të mos lejuar depërtimin e revizionizmit

Në kohën kur Komiteti Qendror i Partisë po shqyrtonte forcimin e punës ideologjike e kulturore në Plenumin e vet në prill 1955, Tuk Jakova u mundua ta shfrytëzonte këtë rast për të goditur vijën e përgjithshme të Partisë, duke shfaqur pikëpamjet e veta revizioniste.

Autokritika që ai pat bërë në Plenumin e 9-të dhe që pat përsëritur në Kongresin II doli se kishte qenë e rreme. Ai vazhdonte të qëndronte në opozitë me vijën e Partisë. Vazh-

donte të ishte i pakënaqur dhe i ngarkuar me një dozë të theksuar urrejtjeje kundër udhëheqjes dhe vijës marksiste-leniniste të saj. Luftën e Partisë kundër oportunitizmit dhe masat e saj kundër armiqve të klasës i kishte gjykuar të padrejta. Duke i vlerësuar nga pozita antimarksiste, revizioniste ngjarjet ndërkombëtare të viteve të fundit, ai kishte filluar punën për të revizionuar vijën e Partisë. Për këtë qëllim ishte afruar me elementët e dënuar nga Partia për veprimtari antimarksiste.

① Tuk Jakova kërkoi rishikimin e gjithë vijës politike dhe organizative të Partisë, sepse, sipas tij, kishte shtrembërime të mëdha që duhej të ndreqeshin sa më parë! Me qëllim të caktuar për të goditur udhëheqjen e Partisë e veçanërisht shokun Enver Hoxha, ai ngriti tezën e njohur armiqësore të udhëheqësve revizionistë jugosllavë, sipas së cilës ata kanë krijuar gjoja Partinë Komuniste të Shqipërisë dhe kanë bërë të mundur të gjitha fitoret e arritura në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar! Ai shtroi revizionimin e vlerësimeve të bëra nga Partia që prej themelimit të saj për punën e grupeve komuniste, sidomos ngulte këmbë që të zvogëloheshin anët e këqija të Grupit të Shkodrës, ku kishte qenë për një kohë në udhëheqje.

② Ai ishte kundër politikës së Partisë lidhur me luftën e klasave. Mbronte tezën e shuarjes së luftës kundër armikut të klasës dhe përpiquej me mënyra të ndryshme të ndalohej në përgjithësi lufta kundër ideologjisë dhe kundër prirjeve e shfaqjeve antiparti, të pranohej kështu bashkëjetesa paqësore me pikëpamjet borgjeze në gjirin e Partisë.

③ Armiqësia e Tuk Jakovës ndaj Partisë kishte arritur deri atje, sa të përdorte në luftën kundër saj edhe parullën reacionare të ndarjes së popullit shqiptar në «gegë e toskë».

④ Tuk Jakova kërkoi hapur të ndërrohej përbërja e Komitetit Qendror të Partisë dhe të vihejshin në krye të saj njerëz të dënuar për faje të rënda dhe veprimtari antimarksiste. Njëkohësisht u shpreh për rehabilitimin e gjithë elementëve antiparti.

Synimet ishin të qarta: të zëvendësohej vija marksiste-leniniste e Partisë së Punës të Shqipërisë me një kurs të ri, si ai i revizionistëve jugosllavë, të dilte Tuk Jakova si «shpëtimtar» dhe «luftëtar i flaktë» për këtë kurs, si njeriu që meritonte të vihej në krye të Partisë.

Me tezat revizioniste të Tuk Jakovës u bashkua Bedri Spahiu.

Bedri Spahiu shumë herë gjatë jetës së vet në parti kishte qenë kritikuar për oportunitizëm të theksuar dhe gabime të rënda në veprimtarinë e tij. Por sa herë e kishte parë rrezik të demaskohej, kishte kërkuar «vullnetarisht» të largohej nga udhëheqja e Partisë me qëllim që të fshihte fajet që rëndonin mbi të. Ai kishte ushqyer kurdoherë nacionalizmin borgjez dhe në mënyrë të heshtur kishte përkrahur rrugën oportuniste e likuidatore të Sejfulla Malëshovës e të Ymer Dishnicës.

Edhe Bedri Spahiu ishte në kundërshtim me politikën e Partisë për klasat e luftën e klasave, që gjunjzuar përpara presionit të borgjezisë dhe kërkonte shuarjen e luftës së klasave. Ashtu si Tuk Jakova, ai ishte për revizionimin e vijës së përgjithshme të Partisë, për zëvendësimin e udhëheqjes së saj me një udhëheqje antimarksiste që duhej të kryesohej nga Tuk Jakova dhe të përbëhej nga elementë të tjerë antiparti.

Në Kongresin II të Partisë Bedri Spahiu nuk u rizgjodh anëtar i Byrosë Politike për shkak të gabimeve të tij të rënda politike në të kaluarën, që u zbuluan plotësisht gjatë vërtetimit të dokumenteve. Që nga kjo kohë urrejtja e tij për Partinë u shtua edhe më shumë dhe ai priste vetëm çastin e volitshëm për të vjellë vrerin kundër saj.

Pikëpamjet dhe veprimtaria oportuniste e Tuk Jakovës dhe e Bedri Spahiut u demaskuan dhe u dënuan pa asnjë ngurrim nga Plenumi i KQ të Partisë, në qershor të vitit 1955. Tuk Jakova u përjashtua nga Komiteti Qendror, më vonë edhe nga Partia, ndërsa Bedri Spahiu, i cili mbajti në Plenum një qëndrim thellësisht armiqësor, u përjashtua përnjëherësh nga Komiteti Qendror e nga Partia.

Duke marrë këtë vendim Komiteti Qendror porosiste: «...të shtojmë pa pushim vigjilencën revolucionare dhe luftën kundër oportunitizmit dhe oportunistëve dhe çdo akt i tyre në dëm të Partisë e të popullit të goditet që në vezë»¹. Në këtë mënyrë u mbrojt uniteti i Partisë, u ruajt e pastër vija e saj e përgjithshme marksiste-leniniste. Komiteti Qendror përgatiti organizatat dhe gjithë komunistët të luftonin kundër

1 Vendimi i Plenumit të KQ të PPSH, 17 qershor 1955. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. II, f. 541.

pikëpamjeve të armiqve që kërkonin të zhvillonin në Parti ndjenjën e dëmshme të qetësisë dhe të shuarjes së luftës së klasave.

Veprimtaria revizioniste e Tuk Jakovës dhe e Bedri Spahtit nuk ishte e rastit. Ajo i kishte rrënjët në veprimtarinë e gjithanshme diversioniste të revizionistëve jugosllavë kundër partive marksiste-leniniste e kundër unitetit të kampit socialist. Ajo që lidhur ngushtë me përgatitjen e sulmit të përgjithshëm të revizionistëve modernë kundër marksizëm-leninizmit dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Pas vdekjes së J. Stalinit në mars të vitit 1953, elementët revizionistë në partitë komuniste e punëtoje, duke përfshirë edhe Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, filluan të gjallëroheshin, të brenin themelet e partive të tyre dhe t'i vinin minat unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Vitet e para pas kësaj ngjarjeje, ata punuan për të forcuar pozitën e veta dhe për të shtënë në dorë drejtimin e partisë, duke larguar nga udhëheqja elementët e shëndoshë me anën e shpifjeve, intrigave e kompleteve. Për këtë qëllim Hrushovi shpërtheu fushatën e luftës kundër të ashtuquajturit «kult të individit». PPSH, duke e dënuar kultin e individit «si një praktikë antimarksiste dhe të dëmshme», nuk ra megjithatë në kurthin që ngriti Hrushovi për të revizionuar vijën politike të Partisë dhe për të përgatitur truallin e ndërrimit të udhëheqjes. Përgjigjja që ajo jepte në këtë rast ishte: «Në Komitetin Qendror dhe në instancat e tjera udhëheqëse të Partisë sonë ka ekzistuar shpirti i kolegjalitetit dhe është luftuar vazhdimisht që puna kolegjiale të forcohet çdo ditë. Komiteti Qendror i Partisë sonë është i bashkuar si një trup i vetëm prej graniti dhe e udhëheq Partinë me urtësi e guxim në rrugën e lavdishme të socializmit e komunizmit. Uniteti i Partisë është si një bllok çeliku që s'do të ketë forcë armike, qoftë e brendshme qoftë e jashtme, që ta dëmtojë»¹.

Në vitet 1954-1955 përgatitjet e revizionistëve për sulmin e përgjithshëm kundër marksizëm-leninizmit morën përpjesëtime të gjera. Veprimtaria e tyre u përqendrua kryesisht në tre drejtime: në përhapjen e idesë së shuarjes së luftës së klasave;

1 Raport i Byrosë Politike, miratuar në Plenumin e KQ të PPSH më 12 korrik 1954. AQP.

në afrimin me klikën e Titos e rehabilitimin e saj; në zëvendësimin e luftës së popujve për ruajtjen e paqes me bashkëpunimin me krerët e imperializmit.

Si pasojë e kësaj veprimtarie në Hungari dhe në disa vende të tjera evropiane të demokracisë popullore u bënë lëshime të dukshme ndaj elementëve kapitalistë në qytet e sidomos në fshat, u lejua përhapja e ideologjisë dhe e kulturës borgjeze. Ndërkaq në RPSH armikut të klasës jo vetëm nuk iu bë asnjë lëshim, por u forcua edhe më shumë lufta kundër tij.

Te rruga që ndiqnin udhëheqësit jugosllavë revizionistë modernë shikonin modelin e rrugës së tyre të përbashkët; te klika e Titos shikonin aleatin e tyre më të sigurt në luftën kundër marksizëm-leninizmit. Në këtë kohë Hrushovi dhe, pas tij, udhëheqës të tjerë të vendeve socialiste filluan të vlerësonin shumë politikën e jashtme të Jugosllavisë, si edhe «përpjekjet e saj për sigurimin e bashkëjetesës paqësore e ruajtjen e paqes». Hrushovi u mundua të vërtetonte se politika e jashtme e Jugosllavisë nuk ndryshonte nga politika e jashtme e vendeve socialiste. Filloi të shfaqej mendimi se çështjet që i bashkonin partitë marksiste-leniniste me revizionistët jugosllavë ishin më të shumta dhe më të rëndësishme nga ato që i ndanin. U bënë përpjekje të gjithanshme për të vërtetuar domosdoshmërinë e rehabilitimit të udhëheqjes revizioniste jugosllave. Në maj 1955 Hrushovi, pa marrë pëlqimin e partive të tjera, vendosi të hidhte poshtë vendimet e Byrosë Informative dhe vlerësimet e gjithë partive komuniste e punëtore lidhur me tradhtinë e klikës së Titos e të shkonte në Beograd në krye të një delegacioni të partisë e të qeverisë sovjetike. Këtë vendim të njëanshëm, të padrejtë dhe arbitrar Hrushovi u përpoq t'ua impononte edhe partive të tjera. Vetëm dy ditë përpara se të nisej, ai e njoftoi Partinë e Punës të Shqipërisë për këtë fakt të kryer dhe i kërkoi asaj që të jepte pëlqimin për hedhjen poshtë të rezolutës së Byrosë Informative të nëntorit 1949 dhe për rishikimin e rezolutës së qershorit 1948, që nxirrnin në shesh tradhtinë e udhëheqjes jugosllave. Njëkohësisht ai donte miratimin e tekstit të një «vendimi» për këtë çështje, të hartuar prej tij, që do të botohej me emrin e Byrosë Informative, pa bërë mbledhjen e saj! Komiteti Qendror i PPSH, me gjithë besimin që kishte ndaj Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, e shikoi me një dyshim të madh këtë gjest të Hrushovit dhe me anë të një letre, dërguar Komitetit Qendror të PK të

BS më 25 maj 1955, u shpreh kundër vajtjes së Hrushovit në Jugosllavi dhe kundër rehabilitimit të klikës së Titos. «Ne mendojmë, — thuhej në këtë letër, — se ka mjaft ndryshim midis përmbajtjes së letrës suaj të datës 23.V.1955 dhe tezës kryesore të qëndrimit tonë të përbashkët të deritanishëm kundrejt jugosllavëve... Eksperiencia e përditshme e Partisë sonë në marrëdhëniet me jugosllavët, si para shkëputjes me jugosllavët në vitin 1948, ashtu edhe më pastaj, gjer më sot, vërteton në mënyrë të qartë e të plotë, me fakte të shumta e të gjalla, se përmbajtja principiale e të gjitha rezolucioneve të Informbyrosë në lidhje me çështjen jugosllave ka qenë plotësisht e drejtë, me ndonjë përjashtim me rëndësi taktike. Procedura që propozohet të ndiqet për aprovimin e abrogimit të rezolucionit të mbledhjes së Informbyrosë në nëntor 1949 na duket se nuk është e drejtë... Sipas mendimit tonë një vendim kaq i shpejtë (dhe i rrëmbyer) mbi një çështje me rëndësi të madhe principiale, pa bërë më parë një analizë të thellë bashkë me të gjitha partitë e interesuara në këtë çështje, dhe aq më tepër publikimi i tij në shtyp dhe dekretuarja e tij në bisedimet e Beogradit jo vetëm do të ishte i parakohshëm, por do të shkaktonte dëme serioze në orientimin e përgjithshëm... Ne jemi të bindur se kjo vijë e përgjithshme e Partisë sonë në marrëdhëniet me Jugosllavinë është e drejtë, me ndonjë përjashtim me rëndësi të dorës së dytë»¹.

Komiteti Qendror i PPSH i kërkonte KQ të PKBS shqyrtimin e këtyre çështjeve në një mbledhje të partive pjesëmarrëse të Byrosë Informative, ku të ftohej edhe PPSH për të thënë fjalën e vet.

Sipas vendimit që kishte marrë, N. Hrushovi shkoi në Jugosllavi, pranoi me përulje përpara Titos se «ishin kryer gabime të rënda kundrejt PKJ dhe udhëheqjes jugosllave» (!) dhe në të vërtetë e rehabilitoi atë. Kjo ishte një ngjarje e paparë në historinë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, një shkelje e hapët e vendimeve të përbashkëta të partive motra, një qëndrim mospërfillës ndaj partive të tjera.

Te kursi revizionist i klikës së Titos Hrushovi gjeti mishërimin e dëshirës dhe të përpjekjeve të tij për t'u afruar me imperializmin amerikan. Ai e shprehu qartë këtë synim në fja-

1 Letër e KQ të PPSH drejtuar KQ të PK të BS, 25 maj 1955. AQP.

limin që mbajti në Beograd. Politika e bashkëpunimit të Jugosllavisë me shtetet e Perëndimit, tha ai, «gjen mirëkuptimin tonë të plotë». Në një bisedë që pati me disa gazetarë amerikanë Hrushovi shfaqi pikëpamjen se lufta për paqen është një nocion politik që qëndron jashtë luftës së klasave, për sigurimin e së cilës janë të interesuar si shtetet socialiste ashtu edhe shtetet imperialiste. Me këtë kuptim që i jepte ai çështjes së paqes, në fakt e hidhte poshtë tezën e njohur leniniste, sipas së cilës imperializmi është burim i luftërave.

Duke u përpjekur të ngrinin në teori këtë pikëpamje të tyre antimarksiste, revizionistët modernë u munduan të paraliznin luftën e gjallë të masave për paqe kundër imperializmit dhe filluan të predikonin si «luftë kryesore» për sigurimin e paqes takimet dhe bisedat me krerët e imperializmit. Nën ndikimin e këtyre përpjekjeve, gjatë vitit 1955 veprimtaria e organizatave ndërkombëtare për ruajtjen e paqes pësoi një rënie të dukshme. Në vend të luftës për paqe, revizionistët po nxirrnin në plan të parë pacifizmin.

Konferencën e kryetarëve të katër fuqive të mëdha, BRSS, SHBA, Anglisë dhe Francës që u mbajt në Gjenevë në korrik të vitit 1955, Hrushovi e quajti si një etapë të re në marrëdhëniet midis shteteve, si një kthesë në përpjekjet për sigurimin e paqes, ndërsa kryetarët e qeverive imperialiste që morën pjesë në të, si njerëz të arsyeshëm që përpiqeshin për sigurimin e paqes. Ai filloi të fliste kudo për «frymën e Gjenevës».

Elementët revizionistë, nën ndikimin e Hrushovit dhe të nxitur prej tij, u gjallëruan edhe në vende të tjera. Në Hungari Imre Nagi u bë një rrezik i madh për Partinë e Punonjëseve Hungarezë dhe për pushtetin popullor, duke u ngritur drejt-përdrejt kundër zhvillimit socialist të fshatit, kundër parimeve të centralizmit demokratik dhe rolit udhëheqës të partisë. Një rol të tillë kishin dashur të luanin në Shqipëri edhe Tuk Jakova me Bedri Spahiun.

Të mbroje marksizëm-leninizmin në këtë kohë dhe të mos lejoje shndërrimin e revizionizmit në një rrymë të bashkuar ndërkombëtare, donte të thoshte të ruaje të pastër vijën marksiste-leniniste në radhë të parë në partinë tënde, ta pastroje këtë nga elementët revizionistë dhe të ruaje të pacenuar unitetin e saj.

PPSH, duke përjashtuar nga radhët e veta Tuk Jakovën dhe Bedri Spahiun dhe duke shkatërruar oportunizmin e djath-

të, jo vetëm nuk lejoi t'i hapej rruga revizionizmit në gjirin e saj, por edhe u përgatit më mirë për luftën e ardhshme kundër shfaqjeve të oportunitetit të djathtë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Plotësimi i planit të parë pesëvjeçar

Lufta e Partisë në frontin politik dhe ideologjik u lidh ngushtë me luftën për plotësimin

e planit të parë pesëvjeçar.

Masat ekonomike për nxjerrjen e bujqësisë nga prapambetja u plotësuan me përsosjen e mëtejshme të planifikimit në bujqësi. Sipas metodës së re të planifikimit, në planin e shtetit për zhvillimin e bujqësisë përcaktohej vëllimi i grumbullimeve të produkteve bujqësore e blegtorale në bazë të detyrimeve, i blerjes së tepricave dhe i shpërblimeve në natyrë për punën e SMT-ve. Ndërkaq, planifikimi i prodhimit bujqësor bëhej drejtpërdrejt nga çdo ekonomi bujqësore shtetërore, kooperativiste dhe individuale në bashkëpunim me organet shtetërore të bujqësisë dhe SMT-të, duke pasur parasysh shfrytëzimin sa më të plotë të kushteve të tokës dhe të klimës në çdo krahinë. Metoda e re çlironte nga puna burokratike shumë specialistë të bujqësisë dhe rriste përgjegjësinë e kuadrove shtetërore në rrethe për drejtimin e bujqësisë.

Të gjitha këto siguruan përparime të rëndësishme në rritjen e prodhimit bujqësor. Më 1955 drithëra buke u prodhuan 53 për qind më shumë se më 1950.

Me një ritëm edhe më të shpejtë u zhvillua prodhimi industrial. Gjatë pesëvjeçarit ky prodhim u shtua mesatarisht çdo vit 23 për qind. Vëllimi i përgjithshëm industrial më 1955 ishte 15,5 herë më i lartë se më 1938.

Zhvillimi i vullshëm i ekonomisë dhe rritja e prodhimit industrial e bujqësor sollën përmirësimin e gjendjes materiale të punonjësve. Të ardhurat kombëtare u rritën rreth 70 për qind. Kjo bëri të mundur që në fund të pesëvjeçarit të merrej vendimi për heqjen e pjesshme të triskëtimit.

Arritje të mëdha u shënuan në zhvillimin e kulturës dhe të arsimit. U zgjerua rrjeti i shkollave dhe u shtua shumë numri i nxënësve e i studentëve. U zhduk në përgjithësi analfabetizmi për moshat deri më 40 vjeç.

Detyra kryesore e planit të parë pesëvjeçar për shndërrimin e Shqipërisë nga një vend bujqësor i prapambetur në një

vend bujqësor-industrial në përgjithësi u plotësua. U krijua baza e industrisë së re socialiste, u zgjerua sektori socialist i bujqësisë, u përgatitën kushtet për shpejtimin e ritmeve të kolektivizimit të bujqësisë dhe për përfundimin e ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit në pesëvjeçarin e ardhshëm.

Në pesëvjeçarin e parë Partia fitoi një përvojë të çmueshme të udhëheqjes së shtetit dhe të ekonomisë për ndërtimin socialist të vendit. Gjithashtu ajo grumbulloi një përvojë të madhe në veprimtarinë e saj për mobilizimin e masave dhe në luftën politike e ideologjike kundër armiqve të klasës të brendshëm e të jashtëm si edhe kundër oportunitizmit të djathtë.